



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 21, dt. 21.12.2022

**MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR
2023-2025 PËR KËSHILLIN E QARKUT**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 date 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes të PBA”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit nr 7 datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018, Udhëzimit nr. 8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”, udhëzimit plotësues nr.23 dt.08.07.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, vendor” Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 1 datë 10.03.2022 “Mbi miratimin e tavaneve përgatitore të PBA 2023-2025”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratojë dokumentin përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 për Këshillin e Qarkut Korçë, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
2. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së dokumentit përfundimtar të PBA 2023-2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Sektori i Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi O. Beqiraj
Juristi Gj. Kristo
Sek. K. Qarkut B. Muço

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

**MBI PËRGATITJEN E DOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
PËRFUNDIMTAR 2023-2025 PËR KËSHILLIN E QARKUT**

Me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Qarkut u ngrit grupi i punës, “Për Menaxhimin Strategjik (GMS)”, për hartimin e dokumentit të PBA-së 2023-2025. GMS në punën e tij është mbështetur në kalendarin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, i cili është miratuar me vendim të Këshillit të Qarkut nr. 16 date 22.12.2021.

Në zbatim të kalendarit për hartimin e PBA 2023-2025, ekipi për menaxhimin e programeve përgatiti dhe paraqiti për miratim tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm në nivel programi. Këshilli i Qarkut Korçë me Vendim nr. 01 date 10.03.2022 ka miratuar tavanet përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025.

Mbi bazën e miratimit të tavanëve të të ardhurave GMS ka përgatitur materialin mbi miratimin e strukturës së programeve mbi bazën e kërkesave për shpenzime korente dhe kapitale për Programin buxhetor afatmesëm 2023-2025.

Mbi bazën e vendimeve të mësipërme Grupi i punës ka punuar për përgatitjen e projekt dokumentit të parë, atij të rishikuar si dhe dokumentit përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025.

Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur puna e GMS :

- *Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligji nr.68 /2017“Per financat e vetqeverisjes vendore”*
- *Ligji nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018.“Për procedurat standarte të Programit Buxhetor afatmesëm të njesive të vetqeverisjes vendore”*
- *Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 07 date 25.02.2022 “Njendryshim në udhëzimin Nr.23 dt.30/07/2018” Për procedurat standarte të Programit Buxhetor afatmesëm të njesive të vetqeverisjes vendore”*
- *Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 28.02.2022 “Per përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2023-2025”*
- *Udhëzimin plotësues Nr.23 dt.08.07.2022 Per përgatitjen e*

Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2023-2025”

- *Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 15 Date 22.12.2021 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2022-2024 për Këshillin e Qarkut”*
- *Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 1 date 10.03.2022 “Mbi miratimin e tavanëve përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”*
- *Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 14 date 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2022”*
- *Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 4 dt. 15.05.2022 “Mbi miratimin paraprak të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 për Këshillin e Qarkut”*
- *Vendimin e Këshillit të Qarkut “Mbi miratimin e dokumentit të rishikuar të PBA-së 2023-2025”*

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA –së 2023-2025

1. Ngritja e grupit të punës

Me Urdhër të Kryetarit të Këshillit të Qarkut u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, mbështetur në programet dhe aktivitetet të miratuara në Këshillin e Qarkut. Grupi i Menaxhimit Strategjik do të mbështetet në kalendarin për hartimin e programit buxhetor afatmesëm miratuar me Vendim të Këshillit të Qarkut nr. 16 date 22.12.2021.

2. Ndarja e kuotave sipas programeve

Ne drejtimin e Kryetarit të GMS, grupi i punës ka punuar për planifikimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 mbështetur në:

- Mundësitë reale të realizimit të burimeve të të ardhurave, si kusht për financimin e shpenzimeve.
- Analizen e realizimit të buxhetit në dy vitet paraardhëse si dhe në realizimin e pritshëm të tij për vitin 2022.
- Ritjen e lejuar të transfertës së pakushtëzuar të parashikuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08 date 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”.
- Shkresa njoftuese për transferencën e pakushtëzuar për vitin 2023 nga ana e Ministrisë të Financave me nr prot 19206 dt 19.10.2022
- Programi i aktiviteteve për vitin 2022 për institucionin e Këshillit të Qarkut të lidhura me objektivat e zhvillimit të qeverisjes vendore.
- Parashikimi i pritshëm i realizimit të kontratave për implementimin e Projekteve të fituara me fonde të Bashkimit Europian në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC Greqi – Shqipëri 2014-2020 dhe 2021-2027.
- Normativat e lejuara të shpenzimeve të miratuara me akte ligjore e nënligjore.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08 date 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, tavanet për transfertën e pakushtëzuar janë planifikuar përkatesisht për vitin 2023, 7.1% më e lartë se në vitin 2022, për vitin 2024 me 5% krahasuar me vitin 2023, dhe për vitin 2025 me 3.2% krahasuar me vitin 2024. Ndërsa

sipas shkresës së Ministrisë të Financave për transfertën e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar për vitin 2023 për Këshillin e Qarkut Korçë është parashikuar në vlerën 70025000. Mendojmë se kjo është një rritje relativisht e mirë duke patur parasysh aktivitetet dhe programet e parashikuara për këtë Program Buxhetor Afatmesëm si dhe niveli i ulët i të ardhurave që realizon Këshilli i Qarkut. Transferta e pakushtëzuar kap rreth 81 % të buxhetit në total. Sipas udhëzimit nr.23 dt.08.07.2022, transfertat e pakushtëzuar do të jetënë të njëjtat nivele sipas detajimit të parashikimit të dërguar në fazën e parë të PBA-së për vitet 2024-2025.

Lidhur me planifikimin e transfertës së kushtëzuar (fondet e deleguara per DAMT ne qark) grupi i punës, duke patur parasysh edhe aktivitetin e kësaj drejtorie si dhe nivelin e rritjes së transfertës së pakushtëzuar, ka parashikuar që rritja e këtij treguesi të jetë në nivelet e rritjes së transfertës se pakushtëzuar.

Lidhur me planifikimin e të ardhurave të vetë institucionit, grupi i punës mori për bazë nivelet e të ardhurave të miratuara me vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 1 datë 10.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore për programin buxhetor afatmesëm”. Gjithashtu rritja e nivelit të të ardhurave përkon edhe me planifikimin që ju është bërë atyre në miratimin e PBA 2022-2024. Për vitin 2023 është parashikuar një rënie e të ardhurave të vetë institucionit, parashikim ky i bazuar në realizimin faktik të këtyre të ardhurave për vitin 2022. Të ardhurat e veta përbëhen nga kontributi financiar i bashkive dhe të ardhurat nga tarifat e shërbimeve që ofron këshilli i qarkut. Aktualisht Këshilli i Qarkut ofron tarifa vetëm nga DAMT dhe shumë rrallë nga arkivi i Urbanistikës.

Pjesë e diskutimit ishin edhe projekt idetë për aktivitetet që do të planifikohen në vitet në vazhdim me synim arritjen e objektivave të Këshillit të Qarkut. Hartimi i kërkesave buxhetore për tre vitet e ardhshme do të shërbejë si tregues kryesor për planifikimin e shpenzimeve sipas programeve dhe aktivitetëve në përmbushje të objektivave të Këshillit të Qarkut, kjo e lidhur edhe me Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 përfundimtar të miratuar në Këshillin e Qarkut në Dhjetor 2021.

Disa nga objektivat kryesore të Këshillit të Qarkut të cilat janë marë në konsideratë në hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm janë si më poshtë:

- *Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.*
- *Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korçë.*
- *Pjesëmarrja në Programet ndërkufitare e me gjerë dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.*
- *Nxitjen e bashkëpunimit midis njesive te qeverisjes vendore te Rajonit, si dhe bashkëpunimin nderrajonal.*
- *Permirësimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.*
- *Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njesive përbërëse të tij, në procesin e Integritimit European.*

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore për tre vitet e ardhme është bërë mbi bazën e të orientimeve të Udhëzimit nr. 8 date 28.02.2022.

Niveli i pagave dhe sigurimeve shoqërore është ritur krahasuar me vitin 2022, pasi ka marrë parasysh edhe rritjen e pagave që u bë me VKM nr.625 dt.28.09.2022 dhe VKM nr 621 dt 28.09.202

Shpenzimet operative janë planifikuar mbi bazën e normativave të miratuara, mbi bazën e realizimit faktik të tyre në periudhat e mëparshme si dhe mbi bazën e aktivitetëve pjesë e të cilave do të jetë Këshilli i Qarkut për vitet në vazhdim. Në këtë zë është patur parasysh situata e krijuar nga Pandemia Covid 19 si dhe ulja e nivelit të borxhit të trashëguar sipas planifikimit.

Shpenzime për financime për të tretë janë lënë pak a shumë në nivelin e vitit 2022 për vitet 2024 dhe 2025. Për vitin 2023 këto shpenzime janë parashikuar më të larta krahasuar me vitin 2022 pasi Këshilli i Qarkut do të jetë pjesë e financimeve të disa aktiviteteve dhe projekteve të reja të Bashkive të Qarkut. Ketu janë planifikuar pjesëmarja e Këshillit të Qarkut në projekte të përbashkëta me organe të ndryshme me fokus përmirësimin e jetës sociale të komunitetit dhe shtresave në nevojë si një nga prioritetet e Këshillit të Qarkut.

Shpenzimet për investime janë planifikuar mbi bazën e realizimit të tyre në periudhat e mëparshme si dhe kërkesat në vazhdimësi nga ana e Bashkive të Qarkut. Pjesëmarja e Këshillit të Qarkut në projekte për investime në infrastrukturë sipas kërkesave të bashkive ka filluar nga viti 2018 dhe do të vazhdojë edhe në këtë Program Buxhetor.

Shpenzime për pjesëmarje në Programet IPA me projekte të fituara me fonde të Bashkimit Europian. Për vitin 2022 do të vazhdojnë financimi i tre projekteve në procespasi dy janë mbyllur. Në vitin 2022 mbyllen edhe 2 projektet e tjera. Në tre vitet e tjera janë planifikuar fonde për bashkëfinancim në Projekte të tjera që presim të finalizohen. Këshilli i Qarkut është aktiv në Programet e celura nga Bashkimi Europian për të krijuar mundësinë e thithjes së sa më shumë fondeve për zhvillimin e Rajonit.

Shpenzimet për Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës janë me fonde nga transfertat e kushtëzuar. Niveli i planifikimit të tyre është bërë bazuar në vitin 2022, me një ritje të fondit të pagave dhe sigurimeve, bazuar në VKM nr.621 dt.28.09.2022

Në total buxheti për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 është parashikuar si më poshtë:

Viti 2023	131194 mijë lekë (janë marë parasysh edhe të ardhurat e trashëguara)
Viti 2024	80947 mijë lekë
Viti 2025	83400 mijë lekë

Bashkëngjitur këtij informacioni janë tabelat analitike e planifikimit të dokumentit të PBA 2023-2025.

3. Detyrimet e prapambetura

Stoku i borxhit deri në 30.11.2022 në total llogaritet në vlerën 280 mijë lekë. Këtu ka vend të sqarojmë për prejardhjen e këtyre detyrimeve. Së pari Këshilli i Qarkut nuk trashëgon fatura të prapambetura nga furnitorë aktualë të pas vitit 2013. Detyrimet e trashëguara i takojnë periudhës 2007-2012 kur Këshilli i Qarkut ka patur vështirësi financiare për shkak të uljes së ndjeshme të Grantit me 35 % të pajustificuar me ulje të funksioneve. Janë marë masat që këto detyrime të amortizohen brenda këtij programi buxhetor.

4. Rreziqet financiare dhe fiskale

Risku kryesor financiar me të cilin përballë Këshilli i Qarkut është mosrealizimi i të ardhurave të parashikuara. Të ardhurat e veta zene një pjesë të vogël të totalit të të ardhurave për vetë faktin se Këshilli i Qarkut arkëton vetëm tarifën e DAMT-së, shumë rrallë tarifën e urbanistikës dhe kontributet e Bashkive. Këto të ardhura janë në nivele të ulta realizimi pasi Bashkitë e Qarkut, edhe pse e kanë detyrim ligjor vazhdojnë të mos derdhin kontributet e tyre për llogari të Këshillit të Qarkut.

Konkluzione

Programi buxhetor afatmesëm 2023-2025 përfundimtar përmban tavanet përgatitore të të ardhurave dhe shpenzimeve, për këtë periudhë. Në këtë program janë mbajtur parasysh kërkesat e UMF Nr. 23 dt. 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, UMF Nr. 8 dt. 28.02.2022 dhe nr. 7 date 25.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”, UMF NR.23 DT.08.07.2022, Njoftimi i Ministrisë të Financave për transferimin e pakushtezuar për vitin 2023 si dhe të gjitha vendimet e Këshillit të Qarkut të miratimit të PBA sipas fazave përgatitore. Në planifikimin e të ardhurave të veta, për periudhën 2023-2025, GMS u mbështet në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.68, datë 24.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, duke mbajtur parasysh:

1. Realizimin e të ardhurave nga kuota e antarsisë nga gjashtë bashkitë përbërse të Qarkut për vitin 2021 dhe të pritshmin e vitit 2022.
2. Realizimin e të ardhurave nga shërbimet që ofron Këshilli i Qarkut.

Ky Program Buxhetor, pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar, të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që qarku do të ketë në dispozicion, për të financuar shpenzimet e tij. Në shpenzimet e planifikuara, janë mbajtur parasysh shpërndarja e tyre sipas programeve buxhetore, ku janë parashikuar shpenzimet për administratën e Këshillit të Qarkut, Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, si dhe shpenzime për pjesëmarrje në Programet IPA Cross Border 2014-2020, nga të cilat 2 projekte kanë përfunduar dhe po zbatohen 3 projektete tjera si i përmendëm më lart, si dhe Programet IPA Cross Border 2021-2027 që është në fazat e para të tij. Mbi bazën e këtyre vlerësimeve institucioni ka përcaktuar tavanet e shpenzimeve të PBA-së, ku në parashikimin sipas programeve, GMS, pati parasysh:

Planifikimin e investimeve mbështetur në zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Europian, si dhe pjesëmarrja në projekte në përmirësim të infrastruktures në Bashkitë e qarkut, nismë kjo e filluar që në vitin 2018 dhe do të vazhdojë edhe për tre vitet e ardhshme të këtij Programi Buxhetor. Kjo nismë e Këshillit të Qarkut synon përmirësimin e infrastrukturës në shërbim të komunitetit. Gjithashtu Këshilli i Qarkut në këtë Program Buxhetor ka planifikuar fonde për pjesëmarrje në Programet IPA Cross Border 2021-2027.

Në totali fondi për investime kap përkatesisht rreth 47.7% të totalit të shpenzimeve për vitin 2023, 46.9% për vitin 2024, dhe 48.5% për vitin 2025, tregues ky mjaft i rëndësishëm.

Shpenzimet për personelin, parashikimi u bë në mbështetje të numrit të punonjësve të planifikuar me ligj, shpenzimet për paga dhe sigurime zënë rreth 30% të buxhetit.

- Në parashikimin për shpenzime operative u mbështetëm në realizimin e shpenzimeve të viteve të kaluara dhe parashikimin e shpenzimeve administrative më të domosdoshme për funksionimin e Institucionit. Shpenzimet operative zënë 21% të buxhetit për vitin 2023, 22% për vitin 2024 dhe 21.5% për vitin 2025.

Ky Program buxhetor afatmesëm është i balancuar (te ardhurat = shpenzimet).

PBA-ja paraprak është publikuar ne faqen ëeb të Këshillit të Qarkut www.korcaregion.com.

Kryetar i Këshillitë Qarkut

Ana VERUSHI

